



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SH.A UJESJELLES LAC KURBIN
ADMINISTRATORI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 05.12.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ERALD-G” SHPK, **Adresa:** Diber Maqellare HERBEL
Zyra në katin e parë, banesa 2- katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna
Maqellarë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Shërbime (Prokurim me mjete
elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-48036-10-31-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mbikqyrje punimesh për objektin: “Ndërtimi i rrjetit
të jashtëm dhe të brendshëm të Ujësjesit të qytetit Laç, Faza e IV-ërt”.

Fondi limit: 4,392,942.96 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e
dyzet e dy pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.152, datë
07.11.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

**Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë
Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik “ERALD-G” SHPK, me numër NIPTI K36306784K.

Vlera e ofertuar: 3,678,419.42 (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë pikë dyzet e dy) lekë **pa TVSH.**

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“G B Civil Engineering” SHPK**, me numër NIPTI **L51825011V & “Margarita Kodra” PF** me numër NIPTI **L11606503B.**

Vlera e ofertuar: 3,672,924.65 (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e katër pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH.**

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“G B Civil Engineering” SHPK**, me numër NIPTI **L51825011V & “Margarita Kodra” PF** me numër NIPTI **L11606503B.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përqjegishme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.4.2 të DST, përkatësisht:

2.4.2 *Oferta ekonomike e paraqitur ng Operatori Ekonomik duhet te jetë domosdoshmerisht në përputhje me VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim,mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe duhet te jetë brenda kufijeve të vlëres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të kësaj VKM.Kjo kërkesë bazohet dhe ne Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot date 25..07.2017.*

“Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016.

-Të gjithë ofertat që do jene me vlere me të ulët se vlera minimale ose më e lartë se vlera maksimale e përcaktuar në VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbykqyrje dhe kolaudim”, do refuzohen.

KVO konstatoi se: BOE ka paraqitur ofertën me vlerë me të ulët se vlera minimale e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor sipas VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e

manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbyqyrje dhe kolaudim”. Gjithashtu sqarojmë se vlerat e përlllogaritura nga Autoriteti Kontraktor sipas VKM Nr .354 datë 11.05.2016 janë: vlera minimale 3,678,419.42 dhe vlera maksimale 4,392,942.96.

2. Gjithashtu operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST, përkatësisht:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë *personelin kryesor (Drejtues Teknik)* të përfshirë në licensen e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) - Inxhinier ndertimi (Profili transport)
- 1 (nje) - Inxhinier Mjedisi

KVO konstatoi se: BOE nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacion sipas kërkesave të AK, për 1(një) Inxhinier ndertimi (Profili transport) dhe 1(një) Inxhinier Mjedisi.

Sqarojmë se BOE ka deklaruar për Ing.ndërtimi Z. Artan Semimi dhe Zj. Margarita Kodra, por KVO konstatoi nga dokumentacioni i BOE që ka paraqitur në SPE se asnjëri nga këto Inxhinierë nuk kanë titullin Inxhinier ndertimi (Profili transport). Gjithashtu BOE ka paraqitur për Ing. Mjedisi Dylbere Prenga, por KVO konstatoi nga dokumentacioni se kjo inxhinierë ka diplomë dhe licence Kimist Teknolog dhe jo Ing.Mjedisi sipas kritereve që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“ERALD-G” SHPK**, me adresë: Diber Maqellare HERBEL Zyra në katin e parë, banesa 2- katëshe në lindje të fshatit herbel, Komuna Maqellarë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **3,678,419.42** (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë pikë dyzet e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Sh.a Ujësjiellës Lac Kurbin, adresa: Lagje Nr.2 Ish komunalja Laç, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të veprohet, siç parashikohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

JO

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DRILON ALIU